

ZHVILLOHET MBLEDHJA E KOMITETIT TE VENDEVE NË RITJE DHE ZHVILLIM TË IOSCO-s

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, janar 2016

ZHVILLIME TË TJERA

- Mbledhje e Komitetit Rajonal Evropian të IOSCO-s
- Workshop “Rimëkëmbja bankare, zgjidhjet për kreditë me probleme, dhe stress testet”
- Trajnim “Sjellja e tregut - dy përafrimet, mbrojtja e investitorit, konsumatorit dhe parandalimi i abuzimit të tregut”
- Zhvillohen mbledhjet e komiteteve të IOPS-it

LAJME NGA RAJONI

- Estoni
- Kosovë
- Kroaci

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Zhvillohet Mbledhja e Komitetit të Vendeve në Rritje dhe Zhvillim të IOSCO-s

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (*International Organization of Securities Commissions, IOSCO*) në bashkëpunim me Autoritetin e Shërbimeve Financiare të Indonezisë (*Indonesia Financial Services Authority, OJK*) organizuan në datat 19-22 janar 2016 në Bali, Indonezi, Mbledhjen e Komitetit të Vendeve në Rritje dhe Zhvillim, GEM. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë është anëtar me të drejta të plota në këtë organizatë.

Komiteti GEM theksoi rëndësinë që tregjet në zhvillim të vazhdojnë të dëshmojnë aftësinë për t'i bërë ballë paqëndrueshmërisë së rritur në ekonominë globale.

Diskutimet në tryezën e rumbullakët me analistë të tregut të kapitalit nga e gjithë bota, prezantuan rreziqet aktuale globale financiare, duke përfshirë ndikimet e rënies së ritmit të rritjes ekonomike, politikat monetare, normat e interesit të Rezervës Federale të SHBA-së, ngadalësimin e ekonomisë kineze, rënien e çmimeve të mallrave, paqëndrueshmërinë në rritje të tregjeve dhe efektet e tyre mbi tregjet në zhvillim.

Komiteti GEM theksoi rëndësinë që tregjet në zhvillim të vazhdojnë të dëshmojnë aftësinë për t'i bërë ballë paqëndrueshmërisë së rritur në ekonominë globale. Në këtë mjedis është e rëndësishme që rregullatorët në tregjet në zhvillim të vazhdojnë të rrisin aftësinë ripërtëritëse strukturore dhe të përqendrohen në ndërtimin e themeleve të forta dhe qeverisjes së fuqishme. Ndër detyra të tjera të ngutshme, Komiteti GEM theksoi qëndrueshmërinë në politikat rregullatore, duke pasur në zbatim mikro-struktura të shëndosha të tregut dhe duke forcuar aftësitë e brendshme institucionale. Komiteti GEM është i angazhuar për të vazhduar bashkëpunimin e tij të rregullt me tregjet për të identifikuar dhe adresuar në mënyrë efektive rreziqet kryesore.

Kryetari i Komitetit GEM, Ranjit Ajit Singh tha se: “Ndryshimet e vazhdueshme strukturore në një peizazh gjithnjë e më të ndërlidhur financiar botëror dhe ciklet e sinkronizuara, kërkojnë tregje të zhvilluara dhe elastike të kapitalit që janë në gjendje të përballojnë paqëndrueshmërinë globale, duke i lejuar tregjet të veprojnë në mënyrë të rregullt”.

Prioritetet e politikës rregullatore

Gjatë takimit, Komiteti GEM diskutoi vazhdimësinë e punës për digjitalizimin dhe ndikimin rregullator të teknologjisë financiare (FinTech) për rregullimin e mbikëqyrjes së tregut. Anëtarët e Komitetit diskutuan edhe punën aktuale në forcimin e qeverisjes korporative dhe sjelljen në treg, duke vënë në dukje rëndësinë e standardeve të larta të qeverisjes në sigurimin e tregjeve të fuqishme të kapitalit dhe ndërtimin e besimit të investitorëve ndërkombëtarë.

Forcimi i elasticitetit kibernetik në tregjet në zhvillim

Komiteti GEM zhvilloi një ushtrim rregullator duke simuluar sulmin e parë kibernetik me pjesëmarrësit e më shumë se 40 juridiksioneve. Fokusi u vendos në mënyrë të veçantë në rolin e rregullatorëve të letrave me vlerë, kur ndeshen me sulme kibernetike mbi tregjet e rregulluara. Simulimi ofroi një platformë kritike për të rritur ndërgjegjësimin ndaj pasojave që sjellin sulmet kibernetike.

Temat kryesore të identifikuara gjatë simulimit ishin:

- Nevoja për një plan të qartë, të mirëpërcaktuar dhe institucionalizuar për menaxhimin e krizave në vend;
- Balancimi i një qasje rregullatore proaktive dhe reaktive për të reaguar dhe për të lehtësuar rimëkëmbjen në rast të një cënimi të madh kibernetik që ndikon subjektet e rregulluara;
- Rëndësia e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërkufitar; dhe
- Rëndësia e komunikimit efektiv dhe të qartë me publikun e gjerë, investitorët, subjektet e prekura, pjesëmarrësit e tregut, agjencitë ligjzbatuese dhe organet e tjera.

Në 22 janar, Komiteti GEM organizoi një konferencë publike “Optimizimi i inovacionit dhe forcimi i qeverisjes në tregjet e reja”. Diskutimet u fokusuan në iniciativat e reja për të mbështetur financimin e bizneseve të vogla dhe të mesme në tregjet e reja, mundësitë dhe përgjigjet rregullatore që dalin nga FinTech dhe rëndësinë e qeverisjes korporative në promovimin dhe mbrojtjen e investitorëve në tregjet në zhvillim.

Komiteti GEM zhvilloi një ushtrim rregullator duke simuluar sulmin e parë kibernetik me pjesëmarrësit e më shumë se 40 juridiksioneve.

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, janar 2016

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për muajin janar 2016 kapën vlerën mbi 1.02 miliardë lekë, ose 13.85% më pak se në muajin janar 2015. Gjatë muajit janar 2016, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 72,134 me një ulje prej 3.05% krahasuar me muajin janar 2015.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 18.72% në krahasim me janar 2015. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 0.16 miliardë lekë, apo 60.51% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

—○○○—
Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë muajit raportues përbën 59.69% të tregut të sigurimeve

Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u ul me 14.47% gjatë muajit janar 2016, krahasuar kjo me muajin janar 2015.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohen të kenë arritur vlerën rreth 0.61 miliardë lekë gjatë muajit janar 2016, duke shënuar një ulje prej 7.50% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë muajit raportues përbën 59.69% të tregut të sigurimeve.

Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:

- Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë të cilat zunë 23.07% të tregut të Jo-Jetës;
- Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësisë të përgjithshme të cilat së bashku zunë 16.45% të tregut të Jo-Jetës.


Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 2.13% krahasuar me periudhën janar 2015. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë me Kursim” e cila përbën 39.57% të sigurimit të Jetës.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar 2016

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 2.13% krahasuar me periudhën janar 2015.



Workshop “Rimëkëmbja bankare, zgjidhjet për kreditë me probleme, dhe stres testet”

Qendra e Ekselencës në Financë në bashkëpunim me Bankën Evropiane për Rindërtim & Zhvillim dhe Bankën Botërore, zhvilluan më 22-24 shkurt në Ljubljana, Slloveni *workshopin* me temë “Rimëkëmbja bankare, zgjidhjet për kreditë me probleme dhe stres testet”. Pjesëmarrës në *workshop* ishin përfaqësues nga rregullatorë të ndryshëm të Evropës Juglindore.

○ ○ ○
Nëse një krizë ndodh, planifikimi i duhur i rimëkëmbjes dhe instrumentet efektive për të ndërhyrë në operacionet bankare vulnerabël mund të ndihmojnë këtë të fundit për të kapërcyer rrezikun financiar.

Referuesit në *workshop* prezantuan planet e vendit të tyre mbi rimëkëmbjen bankare dhe stres testet që zhvillojnë. Rimëkëmbja e ngadaltë e sektorit bankar dhe atij financiar në tërësi është një shqetësim që shumë vende në Evropën Juglindore po përpiqen ta trajtojnë gjatë punës së përditshme në mënyrë që të sigurojnë stabilitet financiar dhe të nxisin një mjedis që mbështet rritjen ekonomike. Në përcaktimin e shkallës së aftësisë, për të rimëkëmbur ekonominë dhe stabilitetin e sektorit financiar, merr rëndësi testimi i aftësive të këtij sektori për t'i bërë ballë goditjeve financiare. Stres test është tashmë një praktikë e njohur në kryerjen e mbikëqyrjes së rregullt bankare, e cila është provuar të jetë një instrument i dobishëm në identifikimin dhe adresimin e dobësive të mundshme.

Nëse një krizë ndodh, planifikimi i duhur i rimëkëmbjes dhe instrumentet efektive për të ndërhyrë në operacionet bankare vulnerabël mund të ndihmojnë këtë të fundit për të kapërcyer rrezikun financiar dhe për ta shpëtuar atë nga dështimi. Për të zvogëluar ekspozimin ndaj rrezikut të bankës, për të mbështetur bilancin e saj të dëmtuar në mënyrë që të arrihet forcimi i kreditit, u sugjerua që ta ketë çdo bankë për kreditë me probleme. Kjo e ndihmon sektorin bankar për të luajtur rolin e tij të rëndësishëm në sigurimin e fondeve për një sektor privat dinamik dhe të mbështesë rritjen e qëndrueshme afatgjatë.

Qëllimi i *workshopit* ishte të sigurojë një platformë për të shkëmbyer eksperiencën në kryerjen e stres testeve në kuadrin e praktikave mbikëqyrëse bankare, për të shkëmbyer mendime mbi planifikimin dhe modalitetet për rimëkëmbjen e bankave, dhe për të diskutuar sfidat me të cilat ato përballen në përshpejtimin e zgjidhjes së problemit të kredive me probleme.

○○○
Trajnimi u përqendrua në mbikëqyrjen dhe zbatimin e metodave të përdorura nga autoritetet për të mbrojtur investitorin dhe konsumatorin.
○○○

Ndër temat e tjera të trajtuara ishin:

- 1.** Planifikimi i rimëkëmbjes bankare dhe natyra e dialogut mbikëqyrës: Reagimi mbikëqyrës dhe masat e marra; Elementet kryesore të planeve të rimëkëmbjes; Vlerësimi i Mbikëqyrjes.
- 2.** Sfidat e politikave në zgjidhjen e kredive me probleme dhe zgjidhjet e mundshme, në mënyrë të veçantë: Kreditë me probleme - ndikimi në bankat dhe sistemin financiar; Kreditë me probleme - përkufizimi dhe mbikëqyrja; Zgjidhjet për kreditë me probleme dhe ristrukturimin e borxhit: strategjitë, institucionet dhe instrumentet.
- 3.** Kryerja e aktiviteteve të rregullta mbikëqyrëse me fokus në sfidat praktike, në hartimin dhe zbatimin e qasjeve të testimit të stresit: Testimi i stresit, pamje e përgjithshme; Qasje të ndryshme të testeve të stresit; Praktikrat aktuale të testimit të stresit në Slloveni; BE (EBA dhe ECB) perspektiva e testeve të stresit.

Trajnimi “Sjellja e tregut - dy përafrimet, mbrojtja e investitorit, konsumatorit dhe parandalimi i abuzimit të tregut”

Banka Qendrore e Armenisë në bashkëpunim me Qendrën Globale për Mbikëqyrjen Financiare (*Toronto Centre*) zhvilluan në datat 22-26 shkurt, në Dilijan, Armeni trajnimin “Sjellja e tregut - dy përafrimet, mbrojtja e investitorit, konsumatorit dhe parandalimi i abuzimit të tregut”.

Trajnimi u përqendrua në mbikëqyrjen dhe zbatimin e metodave të përdorura nga autoritetet për të mbrojtur investitorin dhe konsumatorin; problemet që dalin nga sjellja në treg e subjekteve që ofrojnë shërbime financiare; si dhe në krahasimin dhe përafrimin e legjislacioneve.



Gjatë zhvillimit të trajnimit “Sjellja e tregut - dy përafrimet, mbrojtja e investitorit, konsumatorit dhe parandalimi i abuzimit të tregut”

Lidhur me tendencat globale dhe çështje të reja për mbikëqyrjen e sjelljes së tregut, u diskutua mbikëqyrja në disa vende.

Nëpërmjet rasteve studimore dhe aktiviteteve në grup pjesëmarrësit diskutuan:

- Natyrën e sjelljes së tregut, si dhe abuzimet e mundshme, të tilla si dhënia e informacionit të rremë, transaksionet e paautorizuara, etj;
- Identifikimin e rrezeve për llojet e ndryshme të produkteve;
- Objektivat e mbikëqyrjes së sjelljes së tregut për perspektivën duke përfshirë dhe ndërmjetësit;
- Hartimin dhe zbatimin e zgjeruar të mjeteve për monitorimin e përmirësuar të sjelljes së tregut;
- Forcimin e kuadrit përkatës rregullator dhe mbikëqyrës;
- Rritjen e kulturës së konsumatorëve, dhe trajtimin e drejtë të konsumatorit e investitorit.

Çështje të rëndësishme që lidhen me mbrojtjen e investitorit, konsumatorit, si dhe parandalimin e abuzimeve të tregut ishin:

1. Çështje që lidhen me abuzimin e tregut:

Natyra e abuzimeve të veçanta; Koncepti i trajtimit të konsumatorit; Diferencimi i bazuar në natyrën e veprimtarisë; Mbikëqyrja e sjelljes së tregut; Risqet e matura që lidhen me sjelljen në treg; Mbrojtja e konsumatorit/investitorit duke bërë dallimin midis konsumatorit/investitorit të çiltër apo të vështirë në krahasim me konsumatorët e tjerë; Kufizimet e mbikëqyrjes së sjelljes së tregut, si dhe kufizimet mbi mbrojtjen e konsumatorit.

Lidhur me tendencat globale dhe çështje të reja për mbikëqyrjen e sjelljes së tregut, u diskutua mbikëqyrja në disa vende, parimet e G20 dhe puna e Bankës Botërore, rregullimi i vetë industrisë, roli i avokatëve të konsumatorit dhe avokatit të popullit, si dhe edukimi i konsumatorit.

2. Çështje që lidhen me trajtimin e ankesave të konsumatorit si:

Ankesa si kontribut për zhvillimin rregullator; Korniza ligjore për monitorimin dhe hetimin; Mënyra e raportimit të ankesave; Trajtimi i ankesave dhe kompetencat e stafit që merret me trajtimin e ankesave.

3. Çështje që lidhen me krahasimin e sjelljes në treg të bankave dhe letrave me vlerë, të cilat përfshijnë:

Mbikëqyrjen *On-Site* duke filluar nga pajtueshmëria e funksioneve të brendshme, roli i bordit drejtues, auditit të brendshëm, vlerësimi i politikave të konfidencialitetit, të sigurisë së të dhënave, trajtimi raportimi i ankesave, etj.

Mbikëqyrjen *Off-Site* duke shfrytëzuar të gjitha mjetet si marrja e informacioneve nga publiku, media, analiza e transaksioneve brenda grupit, burime informacioni nga institucione të tjera, etj.

○○○
Diskutimet u fokusuan kryesisht në raportimet, gjetjet kryesore për projektet në proces të IOPS-it.
○○○

4. Çështje që lidhen me zbatueshmërinë dhe vendosjen e masave të cilat përfshijnë: Zbatimin e masave korrigjuese dhe sanksionet, proporcionaliteti dhe arsyetimi mbi vendosjen e masave, koordinimi midis departamenteve për çështje në funksion të rregullimit të tregut.

Lidhur me këtë temë u zhvilluan raste studimore duke trajtuar mënyra të ndryshme të masave si: Pezullimi i tregtimit të një produkti, ndalimi i një linje biznesi, ndryshimi i menaxherëve, auditimi, etj.

Një vend të veçantë në këtë trajnim pati dhe trajtimi i konfliktit të interesit si: Kuptimi i konfliktit të interesit, si ndikon ai në shërbimet financiare dhe si mund të identifikohet një konflikt interesi. Përveç rasteve studimore që u trajtuan për këtë çështje, çdo pjesëmarrës bëri një prezantim të legjislacionit të vendit të tij.

Zhvillohen mbledhjet e komiteteve të IOPS-it

Në datat 24-26 shkurt 2016, në Romë, Itali, u zhvilluan mbledhjet e komiteteve të IOPS-it.

Në ditën e parë u prezantua eksperiencia italiane lidhur me metodën e re të raportimit nga fondet e pensione në autoritetin mbikëqyrës (COVIP). Më tej përfaqësues të autoriteteve të vendeve pjesëmarrëse komentuan rreth modelit italian të raportimit dhe prezantuan eksperiencat e tyre lidhur me organizimin dhe përdorimin e të dhënave të grumbulluara nga sistemet e raportimit të fondeve të pensione.

Diskutimet u fokusuan kryesisht në raportimet, gjetjet kryesore për projektet në proces të IOPS-it. U diskutua për një rishikim të mundshëm të parimeve të mbikëqyrjes së pensioneve private (*IOPS Principles of Private Pension Supervision*). Parimet janë rishikuar në 2010, në kuadër të parimeve bazë të Rregullores së Pensioneve Private të OECD (*OECD Core Principles of Private Pension Regulation*) ku përfshihen edhe parimet e IOPS-it (*IOPS Principles*). Anëtarët u ftuan të marrin pjesë në një diskutimin paraprak jo formal për ndërmarrjen e rishikimit të këtyre parimeve.

Tjetër temë interesante ishte bashkëpunimi ndërkombëtar. Përfaqësuesja e Sllovakisë prezantoi projektin e IOPS-it për bashkëpunimin e IOPS-it me organizata të tjera ndërkombëtare, përfshirë edhe G20.

Në përfundim të paneleve u diskutua mbi sistemet e pensioneve me llogari individuale, konkurrencën, kostot dhe eksperiencat e mbikëqyrjes në Evropë, Amerikën Latine dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Qëllimi i këtyre diskutimeve ishte shkëmbimi i eksperiencave të zgjedhura Evropiane dhe Amerikano-Latine në krijimin e sistemeve me llogari individuale (*funded pension*). U prezantuan e u diskutuan edhe çështje si konkurenca, struktura e tregut, kosto, masat rregullatore dhe eksperiencat mbikëqyrëse.

Mbledhje e Komitetit Rajonal Evropian të IOSCO-s

Komiteti Rajonal Evropian (ERC) zhvilloi në datat 28-29 janar, në Stokholm, Suedi, mbledhjen e Komitetit Rajonal Evropian të IOSCO-s. IOSCO është institucioni që vendos standardet botërore për rregullimin e tregjeve të kapitaleve dhe forumi i parë botëror për bashkëpunimin ndërmjet rregullatorëve. Në këtë takim merrnin pjesë përfaqësues të autoriteteve mbikëqyrëse të tregut të letrave me vlerë. Anëtarë të këtij Komiteti janë 49 vende.

Mbledhjen e Komitetit e drejtoi z. Jean-Paul Servais, Kryetar i Autoritetit Rregullator të Belgjikës. Tematikat kryesore të trajtuara në këtë mbledhje, lidheshin me:

- Iniciativat për rritjen e kapaciteteve, si dhe masat për të forcuar transparencën në IOSCO;
- Risqet në tregjet financiare, si dhe iniciativat e rregullatorëve.

Autoriteti rregullator i Suedisë bëri prezantime lidhur me efektin potencial të rregulloreve për likuiditetin në tregun e Letrave me Vlerë, si dhe masat për të përmirësuar transparencën e tregut të Letrave me Vlerë të korporatave në Suedi.

Anëtarët pjesëmarrës në mbledhjen e Komitetit shkëmbyen eksperiencat më të fundit në tregjet e tyre. Në takim u diskutua gjithashtu dhe për procedurat për zgjedhjen e kryetarit dhe sekretarit të përgjithshëm të Komitetit.

Gjatë mbledhjes u bene prezantime lidhur me efektin potencial të rregulloreve për likuiditetin në tregun e bondeve.

Estoni

www.xprimm.com

Sipas të dhënave paraprake për vitin 2015 të botuara nga Bordi i Statistikave Kombëtare të Estonisë, tregu i sigurimeve i Estonisë arriti një volum të primeve të shkruara bruto prej 361.2 milionë euro. Kjo shpreh një rritje prej 6% krahasuar me vitin e kaluar. Dëmet e paguara gjatë kësaj periudhe u rritën me 9.2% krahasuar me vitin 2014 duke arritur në 207 milionë euro. Këto shifra pasqyrojnë veprimtarinë e siguruesve të Estonisë dhe të degëve të tjera të siguruesve të BE-së për rreziqet e siguruar vetëm në Estoni.

Në segmentin e sigurimit të Jetës, grupi më i madh ishin produktet e lidhura me skemat e investimeve, i ndjekur nga sigurimi i pensioneve. Në përgjithësi, sektori i sigurimit të Jetës raportoi një rritje prej 3.6% të primeve të shkruara bruto.

Në segmentin e sigurimeve të Jo-Jetës, primet e shkruara bruto arritën në 278.8 milionë euro, e cila shpreh një rritje prej 6.7% më shumë se viti i kaluar. Primet e shkruara bruto patën rritje më të madhe për produktet si: Kartoni Jeshil që arriti një shifër prej 95.6 milionë euro, duke zënë 26.5% të totalit të tregut, sigurimi i pasurisë arriti në 73.5 milionë euro dhe MTPL arriti në 71 milionë euro.

Kosovë

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të para të publikuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, në fund të vitit 2015 tregu i sigurimeve realizoi një volum të primeve të shkruara bruto 78.77 milionë euro, me një rënie prej 1.64% krahasuar me vitin e kaluar. Dëmet e paguara arritën në 36.97 milionë euro, shifër e cila është 18.6% më shumë se në vitin 2014.

Segmenti MTPL ka ruajtur pozicionin dominues në treg. Tendencë negative është vërejtur në klasat e sigurimeve për policat kufitare, primet e shkruara bruto të cilave ranë me 30.3%, duke arritur në vlerën 10.17 milionë euro. Në të njëjtën kohë, primet e shkruara bruto për MTPL u rritën me gati 2%. Megjithatë, në klasën MTPL vëllimi i dëmeve të paguara u rrit me një ritëm shumë më të lartë, prej 19.5% krahasuar me vitin e kaluar.

Sqarim: MTPL (Përgjegjësi motorike ndaj palëve të treta)

Tregu i sigurimeve kroate pati një trend rritës gjatë vitit 2015. Volumi i primeve të shkruara bruto u rrit me 2.26%, duke arritur në 1.14 miliardë euro. Sigurimet e Jetës në totalin e tregut zunë 33.6%. Ato patën një rritje krahasuar me vitin e kaluar, me 11.6% të primeve të shkruara bruto. Segmenti i sigurimeve të Jo-Jetës pati rënie të volumit të primeve me rreth 2%, e shkaktuar kryesisht nga rënia e tarifave të MTPL-së.

Klasat e sigurimit MTPL mbajnë peshën më të madhe në portofolin e sigurimeve të Jo-Jetës, por për shkak të liberalizimit të disa prej tarifave, ato humbën rreth 4 pikë përqindje në totalin e primeve të shkruara bruto. Sipas Byrosë Kroate të Sigurimeve (*Croatian Insurance Bureau, HUO*) numri i policave të sigurimit MTPL u rrit me 2.72% . Sipas HUO, çmimi mesatar për MTPL e detyrueshme arriti në HRK 992.98 (rreth 130 euro) ose 17.02% më pak krahasuar me vitin e kaluar.

Në fund të vitit 2015, primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 11.24% krahasuar me vitin e kaluar. Edhe pse në terma absolutë pjesa më e madhe e rritjes së primeve erdhi nga linjat tradicionale të sigurimit të jetës, dinamikën më të lartë të rritjes e kishin produktet e lidhura me skemat e investimeve, të cilat u rritën me 77.06% në bazë vjetore.

Dëmet e paguara nga siguruesit kroate arritën në 601 milionë euro, me një rritje prej 4.45% në krahasim me vitin e kaluar.

Sqarim: MTPL (Përgjegjësi motorike ndaj palëve të treta)

The logo for the Albanian Financial Markets Authority (AMF) features the lowercase letters 'amf' in a dark red color, followed by the word 'ALBANIA' in white uppercase letters. The text is set against a light gray background that is divided into two rectangular sections.

amf **ALBANIA**

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al